



**REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA**  
**KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK**

**Republika e Kosovës;**  
**Kuvendi i Komunës së Junikut;**  
**Numër: 02-180/02/22**  
**Datë: 20.01.2022 .**

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

**FTESË**

**Për:** Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;  
**Nga:** **Shpejtim Gacaferi** – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;  
**Lënda:** Mbledhja e dytë-(2022) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Junikut;  
**Vendi:** Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;  
**Data:** 28.01.2022, ora 10<sup>00</sup>.



**Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara dt. 06/12/2021 dhe dt. 28/12/2021;
2. Themelimi i Komiteteve të përhershme :
  - 2.1. Komiteti për Politikë dhe Financa , dhe
  - 2.2. Komiteti për Komunitete;
3. Zgjedhja e përfaqësuesit nga ana e Kuvendit Komunal të Junikut si përfaqësues në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës / AKK/ ;
4. Prezantimi i Qeverisë Komunale nga ana e Kryetarit të Komunës ;
5. Të ndryshme



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK  
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



|                       |                                                       |
|-----------------------|-------------------------------------------------------|
| REFERENC-Ë:           | Numër: 02-01/21                                       |
| PËR/ZA/TO:            | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik                     |
| NGA/OD/FROM           | Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATE/A                | 28.12.2021                                            |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal                                          |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së kuvendit të komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

### PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së parë (1) të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2021 me datë: 28.12.2021, në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. **Shpejtim Gacaferi**: i cili në fillim përshëndeti kryetarin e Komunës: z. Ruzhdi Shehun, komandin e policisë z.Rasim Sylaj, bashkëvendësit nga diaspora qe ishin prezent, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit.

**z. Shpejtim Gacaferi: E kaloi fjalën të Kryetari i Komunës z. Ruzhdi Shehu.**

**z. Ruzhdi Shehu:** fillimisht përshëndeti Kryesuesin e Kuvendit Komunal, të gjithë pranishmit, z.Rasim Sylaj Komandant i Policisë në Junik, përfaqësuesit nga mërgata, anëtarët e Kuvendit Komunal.

**z.Ruzhdi Shehu** fillimisht shfrytëzoi rastin të përshëndes fillimin e punimeve të legjislaturës së re pas dhënies së betimit, se pari ju urojë shëndet dhe punë të mira për qytetaret e Komunës së Junikut, siç është edhe detyra juaj si anëtarë të Kuvendit Komunal, qe jeni të zgjedhur nga qytetarët e Junikut, bashkëpunimi nuk do të mungojë nga unë asnjëherë me ju si kuvendar, por kërkoj edhe nga ju që të kemi bashkëpunim për punët dhe interesat e përgjithshme për qytetarët e Junikut.



Mbledhja u organizua duke respektuar udhëzimet e IKSHPK-së.

#### Anëtarët prezent

- |                                       |                                      |
|---------------------------------------|--------------------------------------|
| 1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK  |                                      |
| 2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK       | 10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK |
| 3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK      | 11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK     |
| 4. Albertina Gacaferi - Anëtare, LDK  | 12. Festina Maloku - Anëtare, AAK    |
| 5. Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK | 13. Xhemë Tofaj- Anëtar, LVV         |
| 6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK       | 14. Eliza Pepshi- Anëtare, LVV       |
| 7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK    |                                      |
| 8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK         |                                      |
| 9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK   |                                      |

Mungoi:

Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV

#### Rendi i ditës

1. Dhënja e betimit të anëtareve të ri të Kuvendit (znj. Lirjeta Shehu dhe Xhemë Tofaj),
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar ( mbledhja konstituive),
3. Caktimi i përfaqësuesve të subjekteve politike pjesëmarrëse në K.K. Junik,
4. Shqyrtimi i propozim Vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit,
5. Të ndryshme.

**z. Shpejtim Gacaferi:** E hapi diskutimin sa i përket rendit të ditës. A dëshiron dikush të merr fjalën. Nuk kishte diskutime . Dhe e hodhi në votim këtë rend të ditës.

**Nga 11 prezent, për ishin 11, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.**

#### **Pika e parë e rendit të ditës**

1. Dhënia e betimit të anëtarëve të ri të Kuvendit (znj. Lirjeta Shehu dhe Xhemë Tofaj)

**z. Shpejtim Gacaferi:** Sa i përket pikës së parë të rendit të ditës, nga KQZ kemi pranuar dy vendime të cilët sipas radhitjes se numrit të votave qe kanë marre ne zgjedhje vinë pasues **znj. Lirjeta Shehu nga LDK dhe z. Xhemë Tofaj nga LVV** do të jenë anëtarë të Kuvendit Komunal

**z. Shpejtim Gacaferi:** Ftoj për ta bërë betimin si anëtarë të Kuvendit Komunal, **znj. Lirjeta Shehu dhe z. Xhemë Tofaj**, dy anëtarët e ri të Kuvendit Komunal e bënë betimin sipas procedurave ligjore.

### **Pika e dytë e rendit të ditës**

#### **2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar ( mbledhja konstituive),**

**z. Shpejtim Gacaferi:** Për pikën e dytë Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar ( mbledhja konstituive), kisha propozuar që të hiqet prej rendit të ditës pasi që nuk kemi arrit ta përgatitim, por do të jetë i gatshëm në mbledhjen e radhës në muajin janar.

### **Pika e tretë e rendit të ditës**

#### **3. Caktimi i përfaqësuesve të subjekteve politike pjesëmarrëse në K.K. Junik,**

**z. Shpejtim Gacaferi:** Po fillojmë me grupin e LDK-së për propozimin për Shef të grupit. I dha fjalën **znj. Ermelinda Lllolluni**.

**znj. Ermelinda Lllolluni :** Në emër të grupit të LDK-së propozoi **z. Sadri Krasniqin** si Shef të grupit

**z. Zenel Maloku:** Në emër të grupit të AAK-së propozoi **z. Leonard Lllolluni** për Shef të grupit.

**znj. Eliza Pepshi:** Në emër të grupit të LVV-së propozoi **z. Lulzim Gacaferi** për Shef të grupit.

**z. Shpejtim Gacaferi:** Kemi 3 propozime nga LDK, **z. Sadri Krasniqin**, nga AAK , **z. Leonard Lllolluni** dhe nga LVV **z. Lulzim Gacaferin**, e hedhi në votim.

**Nga 14 prezent, për ishin 14, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.**

### **Pika e katërt e rendit të ditës**

#### **4. Shqyrtimi i propozim Vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit,**

**z. Shpejtim Gacaferi:** E hapi diskutimin sa i përket kësaj pike. Iu dha fjalën në emër të grupit.

**z. Sadri Krasniqi:** Si grup pajtohem me orarin e mbledhjeve në ora 10:00.

**z. Leonard Lllolluni:** Ne si grup i AAK-së pajtohem me orarin e mbledhjeve në ora 10:00.

**Nga 14 prezent, për ishin 14, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.**

## **Pika e pestë e rendit të ditës**

### **5. Të ndryshme,**

**z. Shpejtim Gacaferi:** sa i përket kësaj pike a ka diskutime: **z. Zenel Maloku** unë e kom një propozim, kur të vjen procesverbali se cila fletë të ketë numrat e vendosur, dhe tjetra, mos të përsëriten gabime të ndryshimi i fjalës si ne te kaluarën .

**z. Shpejtim Gacaferi:** E shpalli të mbyllur mbledhjen e parë të Kuvendit Komunal në Junik, shfrytëzojë rastin t'iu urojë festat e fund vitit ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11:00.

Procesmbajtësi:

z. Arton Krasniqi

---

Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi

---